



BASHKIA
TIRANË

Drejtuar: Operatorit ekonomik "Hastoçi" shpk
Adresa: Farkë e Vogël, Lagjja Eurolingua, Komuna Farkë, Tiranë.

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: "Procedurë e Hapur" "Rehabilitimi i kanalit të Skoranës"

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: "Rehabilitimi i kanalit të Skoranës".

Fondi limit: 12,203,895 (dymbëdhjetë milion e dyqind e tre mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës në zbatim të VKB Nr. 29, datë 05.04.2017, për një shtesë dhe disa ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak të Tiranës Nr. 84 datë 29.12.2016 për "Miratimin e Programit Buxhetor afatmesëm 2017-2019 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2017.

Kohëzgjatja e kontratës: 90 (nëntëdhjetë) ditë kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 28.06.2017, ora 10:00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 22 datë 05.06.2017.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik "Senka/L" shpk, NUIS J94808405R

Vlera e ofertës = **0** (zero) lekë pa TVSH.

2. Operatori ekonomik "Nika" shpk, NUIS J76705047U

Vlera e ofertës = **8,685,746** (tetë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e dyzetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

3. Operatori ekonomik "Elira" shpk, NUIS J63423410S

Vlera e ofertës = **8,938,785** (tetë milion e nëntëqind e tridhjetë e tetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

4. Operatori ekonomik "Hastoci" shpk , NUIS B J62028009

Vlera e ofertës = **9,848,208** (nëntë milion e tetëqind e dyzetë e tetë mijë e dyqind e tetë) lekë pa TVSH.

5. Bashkimi i Operatorëve ekonomikë "G.A.C" shpk & "Shansi-Invest" shpk & "Everest" shpk, NUIS J61924002T, NUISJ8311921L

Vlera e ofertës = **10,373,012** (dhjetë milion e treqind e shtatëdhjetë e tre mijë e dymbëdhjetë) lekë pa TVSH.

6. Operatori ekonomik "Alb Shpresa" shpk, NUIS J72110003F

Vlera e ofertës = **10,560,000** (dhjetë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

7. Operatori ekonomik "Liqeni VII" sh.a, NUIS K01730502W

Vlera e ofertës = **10,695,497.28** (dhjetë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë pikë njëzetë e tetë) lekë pa TVSH.

8. Operatori ekonomik "Inerti" sh.p.k, NUIS J66926804L

Vlera e ofertës = **10,720,788** (dhjetë milion e shtatëqind e njëzetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

9. Operatori ekonomik "Shendelli" sh.p.k, NUIS K07924803N

Vlera e ofertës = **10,774,775** (dhjetë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

10. Operatori ekonomik "Bahas" sh.p.k, NUIS J61827083D

Vlera e ofertës = **11,593,462** (njëmbëdhjetë milion e pesëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë pa TVSH,

Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Operatori ekonomik "Senka/L" shpk, NUIS J94808405R

- Operatori ekonomik "Senka/L" shpk nuk plotëson pikën c të kriterëve të vecanta të Kualifikimit pasi nuk ka paraqitur Përshkrimin e Ofertës sipas Shtojcës 1.

2. Operatori ekonomik "Nika" shpk, NUIS J76705047U

- Pas verifikimit të dokumentacionit shoqërues për kamionçinat e deklaruar në Shtojcën 9, u konstatua se asnjë prej tyre nuk plotëson tonazhin e kërkuar 3.5- 5 Ton, çka bie

në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 12, *“Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të disponojë 2 (dy) kamionçinë me kapacitet mbajtës 3.5 - 5Ton”*.

- Operatori ekonomik ka deklaruar në shtojcën 9 mjetin “Eskavator me goma, me targa ABMT 55, të cilit i ka përfunduar afati i vlefshmerisë së certifikatës së kontrollit teknik, në datë 06.04.2017 si dhe siguracioni i mjetit, në datë 07.04.2017 çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 12, germa a).
- Për mjetin “Eskavator me goma”, të deklaruar në Shtojcën 9, me Nr shasie ZEFI157ËTA00000468, nuk janë paraqitur dokumentat e mjetit si (Leje qarkullimi, certifikate e kontrollit teknik si dhe siguracioni i mjetit), çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 12, germa a).
- Operatori ekonomik ka paraqitur Certifikatë ISO 9001-2008, të cilës i ka mbaruar afati i vlefshmërisë me datë 26.6.2017, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 9, në të cilën kërkohet se: *“Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 9001-2008 (e vlefshme)*.
- Operatori ekonomik ka paraqitur Certifikatë ISO 14001-2004, të cilës i ka mbaruar afati i vlefshmërisë me datë 26.6.2017, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 10, në të cilën kërkohet se: *“Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 14001-2004 (e vlefshme)*.
- Operatori ekonomik ka paraqitur Certifikatë OHSAS 18001-2007, të cilës i ka mbaruar afati i vlefshmërisë me datë 26.6.2017, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 11, në të cilën kërkohet se: *“Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë OHSAS 18001-2007(e vlefshme)*.

3. Operatori ekonomik “Elira” shpk, NUIS J63423410S

- Operatori ekonomik “Elira” shpk nuk ka paraqitur vërtetimin për shlyerjen e taksave vendore të parashikuar nga Pusheti Vendor për vitin 2017, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 3.
- Operatori ekonomik “Elira” shpk nuk ka paraqitur vërtetimin për numrin e punonjëse për muajin Prill 2017, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 4, germa a), ku ndër të tjera kërkohet : *“Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; per periudhen Prill 2016 - Prill 2017.*
- Nga verifikimi I dokumentacionit të paraqitur për manovratorët rezulton se kontrata e punës për dy manovratorë është e pavlefshme, pasi ju ka mbaruar afati i kohezgjatjes së tyre, përkatësisht në datë 08.01.2017 dhe 08.04.2017 çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 8, ku ndër të tjera kërkohet se: *“Operatori ekonomik ofertues duhet të kenë të punësuar minimalisht 4 (katër) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në list-pagesat e shoqërisë”*.
- Pas verifikimit të dokumentacionit shoqërues për kamionçinat e deklaruar në Shtojcën 9, u konstatua se Kamionça me targa TR2656F, me tonazh 2,3 ton i ka mbaruar afati i vlefshmërisë së siguracionit të mjetit, në datë 17.06.2017, si dhe nuk plotëson tonazhin e kërkuar 3.5- 5 Ton, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të

Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 12, ku ndër të tjera përcaktohet se: “Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të disponojë 2 (dy) kamionçinë me kapacitet mbajtës 3.5 - 5Ton”.

- Pas verifikimit të dokumentacionit për mjetet e deklaruara në shtojcen Nr. 9, u kostatua që për mjetet Autobetoniere me targa TR3707L dhe Autobetoniere me targa TR0413L nuk janë paraqitur foto, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 12, germa e) “Operatori ekonomik **duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit**”.

4. Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “G.A.C” shpk & “Shansi-Invest” shpk & “Everest” shpk, NUIS J61924002T, NUIS J8311921L

- Operatori ekonomik “G.A.C” shpk nuk plotëson pikën 1 të Kapacitetit ekonomik dhe financiar të Dokumentave Standartë të Tenderit: “Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2014, 2015, 2016) të paraqitur në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar”, pasi nuk ka paraqitur kopje të certifikuara të bilanceve për vitet ushtrimore 2014 dhe 2015 shoqëruar me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar.
- Operatori ekonomik “G.A.C” shpk nuk plotëson pikën 2 të Kapacitetit ekonomik dhe financiar të Dokumentave Standartë të Tenderit: “Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2014, 2015, 2016) lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e se ciles duhet të jete jo më e vogel se vlera e fondit limit perkatesisht: 12,203,895 (dymbëdhjetë milion e dyqind e tre mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH”, pasi nuk ka paraqitur xhiron vjetore për vitet ushtrimore 2014 dhe 2015.
- Operatori ekonomik “G.A.C” shpk nuk plotëson pikën 12 të Kapacitetit teknik dhe të Dokumentave Standartë të Tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 9)/ Kamionçinë për transport me kapacitet mbajtës 3.5 – 5 ton”, pasi ka deklaruar dhe ka paraqitur dokumentacion për kamionin me targë TR 7112G me kapaciteti 19 ton dhe kamionin me targë AA194MF, me kapacitet 17 ton, pra jo kamioncinë për transport me kapacitet mbajtës 3.5-5 ton.
- Operatori ekonomik “G.A.C” shpk nuk plotëson pikën 12 të Kapacitetit teknik dhe të Dokumentave Standartë të Tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 9)/ Kamion me vinç 5 ton”, pasi nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur për kamionin me vinc me targë TR 1508R, rezulton të ketë një kapacitet 3,5 ton.
- Operatori ekonomik “G.A.C” shpk nuk plotëson pikën 12 të Kapacitetit teknik dhe të Dokumentave Standartë të Tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 9)/ Autobetoniere”, pasi për mjetin e deklaruar si Autobetoniere, nuk ka paraqitur dokumentacionin teknik kërkuar sipas pikës 12.a të kriteve te vecanta.

5. Operatori ekonomik “Alb Shpresa” shpk, NUIS J72110003F

- Operatori ekonomik “Alb Shpresa” shpk nuk plotëson pikën 1 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën: Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 6,101,947.5 (gjashtë milion e njëqind e nje mije e nentëqind e dyzete e shtate pike pese) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë tri viteve të fundit. Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlere monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 24,407,790 (njetete e kater milion e katerqind e shtate mije e shtateqind e nentedhete) lekë pa TVSH. Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme. Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme: Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm: Deklaratën sipas shtojcës Nr. 8, shoqëruar me: Kontratë, Situacionin përfundimtar; Aktin e kolaudimit; Çertifikaten e marrjes ne dorezim”* pasi për kontratën me objekt “Ndërtim Ura Mat” nuk ka paraqitur **Çertifikatën e Marrjes në dorëzim** të objektit dhe për kontratën me objekt: “Rikonstruksion Shengjin- Kune”, u konstatua se kontrata nuk është paraqitur e plotë, si dhe nuk është paraqitur **Akt-Kolaudimi**.

6. Operatori ekonomik “Liqeni VII” sh.a, NUIS K01730502W

- Operatori ekonomik “Liqeni VII” sh.a nuk plotëson pikën 3 të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm: Librezë pune (perkatëse), CV perkatëse, Kontrate pune e vlefshme (përkatëse), Diplome”* pasi ka deklaruar si Drejtues Teknik të paangazhuar z. Leo Manesterliu i cili rezultat të jetë i angazhuar si Drejtues Teknik në kontratën Nr. 7291/5.Prot, datë 07.06.2017 lidhur me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tiranë me objekt: “Ndërtimi i rrugëve të bllokut që kufizohet nga rrugët “Bashkim Kodra”- “Shkretëve”-“Shpëtim Zajmi”-“Spahiu”-“Ali Shefqeti”.
- Operatori ekonomik “Liqeni VII” sh.a nuk plotëson pikën 12 të Kapacitetit teknik dhe të Dokumentave Standartë të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 9)/ Kamionçinë për transport me kapacitet mbajtës 3.5 – 5 ton”,* pasi kamioncina me targë DR9043D me kapacitet 1.7 ton dhe kamioncina me targë AA638KT, me kapacitet 0.84 ton nuk plotësojnë tonazhin e kërkuar.

7. Operatori ekonomik “Inerti” sh.p.k, NUIS J66926804L

- Operatori ekonomik “Inerti” sh.p.k nuk plotëson pikën 12 të Kapacitetit teknik dhe të Dokumentave Standartë të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 9)/ Kamionçinë për transport me kapacitet mbajtës 3.5 – 5 ton”,* pasi Kamionit me vinc te deklaruar ne shtojcen 9 me targe EL1401C i ka perfunduar afati i certifikates se transportit te mallrave, me date 02.02.2017.
- Operatori ekonomik “Inerti” sh.p.k nuk plotëson pikën 12 të Kapacitetit teknik dhe të Dokumentave Standartë të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në*

dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 9)/ Kamionçinë për transport me kapacitet mbajtës 3.5 – 5 ton”, pasi per kamionet me targe AA086PI dhe AA 691PT te deklaruar ne shtojcen 9, dokumentacioni teknik, leja e qarkullimit është paraqitur e paplotë.

- Operatori ekonomik “Inerti” sh.p.k nuk plotëson pikën 8 të Kapacitetit teknik dhe të Dokumentave Standartë të Tenderit: *“Operatori ekonomik ofertues duhet të kenë të punësuar minimalisht 4 (katër) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në list-pagesat e shoqërisë”* pasi per manovratorët e kërkuar nuk jane paraqitur deshmite e drejtimit.
- Operatori ekonomik “Inerti” sh.p.k nuk plotëson pikën 4b të Kapacitetit teknik dhe të Dokumentave Standartë të Tenderit: *“List-pagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen Prill 2016 - Prill 2017, shoqëruar me formularet e deklarimit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore”* pasi nuk ka paraqitur formularet e deklarimit te pagesave per sigurimet shoqërore dhe shëndetësore per periudhen Prill 2016-Dhjetor 2016.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “Hastoçi” shpk**, me adresë: **Farkë e Vogël, Lagjja Eurolingua, Komuna Farkë, Tiranë.**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **9,848,208** (nëntë milion e tetëqind e dyzetë e tetë mijë e dyqind e tetë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 07.07.2017

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.